Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.22.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Florim Maliqi (udhëheqës ekipi), Qëndresa Sogojeva dhe Lumturije Sopi (anëtare ekipi) nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymberi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit....6

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm....7

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli....11

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve....21

5 Qeverisja e mirë....22

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA....25

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme....28

Shtojca III: Komentet e OB-së në gjetjet e raportit të auditimit....31

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë se Zhvillimit Ekonomik për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, për vitin 2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë se Zhvillimit Ekonomik.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm

<u>Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes</u>

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

<u>Theksimi i çështjes</u>

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se investimet/transferet kapitale ishin mbivlerësuar për 318,584€, detyrimet kontigjente në vlerë prej 3,504,342€ nuk janë shpalosur në pasqyrat financiare, si dhe pasuritë si investime në vijim në vlerë prej 4,421,627€ nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Opinioni-Theksimi i çështjes pasqyron dobësitë në kontrolle për të konfirmuar klasifikimin e duhur të shpenzimeve, prezantimin dhe shpalosjen e detyrimeve kontigjente si dhe regjistrimin e pasurisë nga investimet në vijim.	Ministri duhet të analizoj arsyen për Theksimin e çështjes në Opinionin e PFV të vitit 2017 dhe t'i identifikoj veprimet që kërkohen për të mundësuar kontrolle adekuate dhe raportim të drejtë dhe saktë në PFV 2018. (Shih nen-kapitullin 2.1)
Dobësi të vazhdueshme janë vërejtur në menaxhimin financiar dhe kontrollet që nderlidhen me shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, subvencionet dhe transferet kapitale për ndërmarrjet publike, prokurimin, detyrimet kontigjente si dhe menaxhimin/prezantimin e pasurive.	Ministri duhet të siguroj menaxhim dhe kontrolle adekuate lidhur me fushat ku janë identifikuar dobësitë, për këtë janë të nevojshme dhe duhet të merren veprime të menjehershme. (Shih nënkapitujt 3.3-3.9)
Rekomandimet për dy vitet paraprake nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.	Ministri duhet të zbatojë një proces me rigoroz për të siguruar që plani i veprimit për rekomandimet e viteve paraprake zbatohet në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore. (Shih kapitullin 4)
NJAB nuk ishte sa duhet funksionale, planin e punës e kishte realizuar vetëm 50%. Auditimet nuk kanë kontribuar dhe ndihmuar menaxhmentin në parandalimin e parregullsive. Po ashtu aranzhimet e qeverisjes kanë shfaqur dobësi.	Minstri duhet te siguroj se do te funksionalizohet plotësisht NJAB dhe të siguroj llogaridhënie dhe qeverisje adekuate në fushat e përcjellura me dobësi dhe në tërë organizatën. (Shih nen-kapitullin 5.1 dhe 5.2)

Përgjigja e Menaxhmentit – auditimi 2017

Menaxhmenti nuk është pajtuar plotësisht me të gjitha të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit. Komentet janë dhënë në detaje në shtojcën III.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Ministrisë se Zhvillimit Ekonomik. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i Pamodifikuar me Theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren e MF nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar të Organizatave Buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

- Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se: nga transferet kapitale, MZHE kishte paguar shpenzime lidhur me vendimet gjyqësore për Ndërmarrjen Publike Trainkos në vlerë prej 194,904€, të cilat nuk ndërlidhen me projektin kapital të aprovuar me buxhet. Për më tepër për Ndërmarrjen Trepça është miratuar/buxhetuar projekti ''Hapja e vend punishteve të reja në horizontet X-XI''(vlera 634,999€). Në emër të këtij projekti Trepça ka lidhur kontratë për furnizime në vlerë prej 53,930€, për këtë vlerë MZHE ka bërë transfer kapital-pagesë për Trepçën. Mirëpo në bazë të kontratës dhe faturës vërehet se artikujt i takojnë shpenzimeve operative, e që nuk kanë të bëjnë me investime. Për më tepër blerjet prej 13,230€ janë për minierat Kishnicë, Hajvali dhe Artanë, që nuk ndërlidhën me projektin e miratuar. Nga këto raste vërehet se monitorimi i projekteve/transfereve kapitale të dhëna nëpërmjet MZHE-së është i dobët. Po ashtu në kuadër të shpenzimeve kapitale është buxhetuar dhe paguar shuma prej 69,750€ në emër të projektit ''Prurjet inerte të lumenjve'', të cilat sipas natyrës janë shpenzime për shërbime të hulumtimeve dhe nuk mund të konsiderohen si kapitale;

- Posta dhe Telekomi i Kosovës kishte bërë padi ndaj Ministrisë (për mos ndarjen e mjeteve për kryerjen e shërbimeve universale dhe të rezervuara, që rrjedhin nga marrëveshja e datës 06.02.2014 ndërmjet PTK dhe MZHE, e bazuar në ligjin 03/L-173 për Posten dhe Telekomin e Kosovës), vlera e këtij pretendimi/padie është 3,504,342€. Gjithashtu nga të dhënat e marra nga Avokatura Shtetërore dhe MZHE janë edhe gjashtë raste/padi tjera në procedurë (pa ndonjë vlerë financiare). Ndërsa ministria nuk ka bërë dhe shpalosur vlerësim të riskut për këto raste si dhe nuk i ka prezantuar në PFV-të e vitit 2017, te detyrimet kontingjente; dhe

- Neni 11 i rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, përcakton se: pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim. Gjatë vitit 2017 MZHE kishte bërë pagesa në vlerë prej 4,421,627€ për projekte/investime kapitale për renovim të objekteve publike dhe investime tjera. Këto pagesa nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël si investime në vijim.

Rastet e lartcekura nuk e kanë modifikuar opinionin por kanë ndikuar në Theksimin e Çështjes në Opinion për vitin 2017.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimit është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me rregullat financiare nr.01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Deklarata e bërë nga menaxhmenti i MZHE-së

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF mund të konsiderohet saktë, meqenëse ekzistojnë gabime që kanë ndikuar në theksimin e çështjes por që nuk kanë ndikuar në modifikimin e opinionit të auditimit.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes në Opinion. Për më tepër, të sigurohet menaxhim i mirë dhe kontrolle adekuate në transferet kapitale për ndërmarrjet (publike) që ato të bëhen vetëm për projektet e aprovuara në Buxhet nga Kuvendi si dhe të ndërmerren veprime specifike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve, në veçanti investimet/transferet kapitale.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë se detyrimet kontingjente trajtohen dhe analizohen me kujdes dhe në koordinim më Avokaturën Shtetërore të sigurohen informata/dëshmi për përfaqësim adekuat të këtyre rasteve/lendeve. Po ashtu duhet bërë vlerësim të riskut të tyre dhe të sigurohen informata/shpalosje të mjaftueshme në PFV.

Rekomandimi 3 Ministri të ndërmarrë veprime për të siguruar kontrolle efikase në procesin e investimeve dhe regjistrimin/raportimin e saktë të pasurive kapitale si dhe Pasqyrat Financiare Vjetore ti nënshtrohen rishikimit dhe vlerësimit rigoroz nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, para se deklarata të nënshkruhet dhe PFV-të të dorëzohen në MF.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në pajtueshmëri lidhur me zbatimin e rregulloreve të prokurimit dhe mbikëqyrjes së pamjaftueshme nga menaxhmenti lidhur me shpenzimet, veçanërisht me transferet kapitale, subvencione dhe transfere dhe shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga MZHE në këto fusha, nga e cila kërkohet që të sigurojë përmbushjen të gjitha obligimeve statutore. Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkon procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve vendore, rregulloreve të brendshme dhe proceseve të tjera të kontrollit.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[1]	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**25,656,991**	**24,372,867**	**22,972,556**	**29,011,107**	**23,609,109**
Granti i Qeverisë -Buxheti	18,389,725	21,105,601	20,223,249	28,166,408	22,097,977
Financimet nga Huamarrjet	4,267,266	3,267,266	2,749,307	844,699	1,473,723
Te hyrat nga AKP	3,000,000	0	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	0	0	0	37,409

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 1,284,124€. Ndryshimet e buxhetit kanë rezultuar me rritjen e buxhetit nga granti qeveritar në shumë prej 2,715,876€, deri sa reduktim të buxhetit ka pasur nga huamarrjet prej 1,000,000€ dhe nga të hyrat nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) në shumë 3,000,000€ në emër të mbrojtjes së arbitrazhit.

Në vitin 2017, Ministria ka shpenzuar 94% të buxhetit final, me një përmirësim prej 4% krahasuar me vitin 2016.

[1] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**25,656,991**	**24,372,867**	**22,972,556**	**29,011,107**	**23,609,109**
Pagat dhe Mëditjet	1,123,242	1,131,242	1,116,910	1,073,641	947,753
Mallrat dhe Shërbimet	4,263,669	3,613,669	2,656,685	3,036,043	3,728,096
Shërbimet komunale	46,210	46,210	18,311	22,341	43,144
Subvencionet dhe Transferet	4,933,870	8,148,682	8,058,014	10,802,604	9,831,120
Investimet Kapitale	15,290,000	11,433,064	11,122,636	14,076,478	9,058,996

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillesatr është rritur për 8,000€. Kjo rritje ishte me vendim të Qeverisë për punësimin e dy punëtoreve të komunitetit serb;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte zvogëluar për 650,000€. Me rishikim të buxhetit është zvogëluar kodi i shpenzimeve të ndryshme intelektuale për 800,000€ përderisa me vendim të Qeverisë kemi një rritje të buxhetit për 150,000€. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte në nivel prej 74%;
- Buxheti final për shërbimet komunale nuk ka pasur ndryshim nga ai fillestar. Realizimi i shpenzimeve komunale është në nivel prej 40%, si rezultat i bartjes së shpenzimeve të energjisë elektrike tek Ministria e Administratës Publike për objekte qeveritare si dhe shpenzimet e energjisë elektrike të mbuluara nga vet Aeroporti i Gjakovës;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere është rritur për 3,214,812€ në krahasim me buxhetin fillestar. Rritja ka ndodhur me rishikim të buxhetit si rrjedhojë e tre vendimeve të Qeverisë për mbulimin e shpenzimeve operative të ndërmarrjeve publike; dhe
- Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me atë fillestar është zvogëluar për 3,856,936€. Me buxhetin fillestar janë planifikuar 19 projekte kapitale. Me rishikim të buxhetit dy projekte në vlerë prej 3,000,000€ nuk janë përfshirë (Programi për zbatimin e ekonomisë digjitale në vlerë prej 2,0000,000€ dhe Programi për zbatimin e energjisë efiçiente 1,000,000€), për shkak se financimi i tyre është paraparë me të hyrat e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, të cilat nuk janë aprovuar në Kuvendin e Kosovës. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 97%.

3.2 Pagat dhe shtesat

Shpenzimet për paga dhe shtesa për vitin 2017 ishin 1,116,910€, të cilat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF.

Në këtë kategori kemi vërejtur se deri në tetor të vitit 2017 kabineti i Ministrit kishte të punësuar 22 zyrtar, katër më tepër se sa ishte planifikuar. Pesë prej tyre nuk ishin përfshirë në listën e pagave, por janë paguar nga kategoria mallra dhe shërbime. Kjo situatë është prezantuar edhe në raportet e auditimit të viteve 2016 dhe 2015, ndërsa nga tetori 2017 kjo çështje ishte mënjanuar/përmirësuar. Testimet tona nuk kanë sjellur çështje tjera në këtë fushë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Menaxhimi i personelit

Ministria është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të personelit në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil. Ne kemi testuar një numër të mostrave për të siguruar se veprimet e ndërmarra në ketë fushë janë në harmoni me legjislacionin përkatës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 3,613,669€ ndërsa shpenzimi ishte 2,656,685€. Shpenzimet kanë të bëjnë me shërbime kontraktuese në vlerë prej 2,087,084€, shpenzime për udhëtim jashtë vendit në vlerë 206,452€ si dhe shpenzime tjera. Auditimi ynë ka shpalosur parregullsi në këto shpenzime, të cilat janë paraqitur në vijim:

Çështja 4 - Vazhdimi i kontratës pa bazë të qartë rregullative

E gjetura

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik[2], përcakton se: nëse aktiviteti i prokurimit përmban një opsion (mundësi vazhdimi i kontratës), vlera e opsionit do të parashikohen dhe përfshihen në parashikimin e vlerës së kontratës. Opsion do të thotë e drejta e autoritetit kontraktues të kërkoj dorëzime shtesë me çmim të njëjtë dhe sipas kushteve të njëjta të përcaktuara në kontratë. Opsione të tilla duhet të përfshihen në publikime dhe të specifikohen në dosjen e tenderit. Përndryshe opsionet nuk mund të kërkohen.

MZHE në vitin 2014 përmes procedurave të prokurimit ka lidhur dy kontrata për shërbime këshillëdhënëse (Këshilltar me marrëdhënie me publikun dhe Këshilltar për çështje të energjisë) për Njësinë e Implementimit të Projektit "TC Kosova e Re". Në njoftim për kontratë ishte cekur se kontratat janë për shërbime dhe nuk ishte paraparë opsioni i vazhdimit të kontratës. Opsioni i tillë ishte paraparë vetëm në dosje të tenderit.

Dy kontratat e testuara ishin lidhur me kohëzgjatje dy vite (2014-2016). Ndërsa në kushtet e veçanta të kontratës është vendosur mundësia e vazhdimit edhe për tri vite si dhe janë futur elemente tjera të kontratës së punësimit[3].

Në prill të vitit 2016 kontratat si të tilla janë vazhduar edhe për tri vite deri më 30.04.2019. Shpenzimet nga këto dy kontrata në vitin 2017 janë 28,427€.

Rreziku

Vazhdimi i kontratave në këtë mënyrë nuk është në përputhje me rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik. Kjo mund të ndikoj që ministria të paguaj shërbime pa konkurrencë, të mos arrihet vlera për paranë.

Rekomandimi 4

Ministri duhet të ndërmerr veprime që të rrisë kontrollet lidhur më kontratat me qëllim që të siguroj se shpenzimi i parasë bëhet përmes kontratave të bazuara dhe me mbështetje ligjore.

[2] Udhëzuesi i prokurimit publik (neni 13.8) dhe dy dokumentet e mëparshme Rregullorja e prokurimit Publik, neni 12.8 dhe neni 2 pika 6 i Udhëzuesi i prokurimit Publik (të cilat ishin në fuqi në kohen e kontratës). Ndërsa kërkesën/termin për opsione e ka parashikuar edhe KRPP në shabllonin njoftim për kontratë.

[3] Me plotësim ndryshimin e ligjit të prokurimit më datë 21.01.2016, neni 3.6 nuk e lejon që ky ligj të zbatohet për kontrata të punësimit.

Çështja 5 – Kontrata për shpenzimet e biletave të udhëtimit

E gjetura

Sipas pikës 13.1 të udhëzuesit operativ të prokurimit publik, vlera e parashikuar e një kontrate publike do të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë reale/e arsyeshme.

Shpenzimet për bileta të udhëtimit jashtë vendit kanë shënuar tejkalim në raport me planifikimin/kontraktimin e tyre. Në kontratë janë parashikuar 30,000€ për vit, ndërsa vetëm në vitin 2017 janë realizuar/shpenzuar 114,076€.

Ministria ka kontratë kornizë "Shërbime udhëtimi me aeroplan për nevojat e MZHE-së", për 36 muaj (nga dt. 23.03.2015 deri 23.03.2018), që ishte para ndryshim/plotësimit të ligjit të prokurimit. Në nenin 3.1 të kontratës është përcaktuar se vlera e kontratës të jetë përafërsisht 30,000€ për vit. Mirëpo, vetëm gjatë vitit 2017 nga kjo kontratë është paguar vlera prej 47,248€ apo 57% më shumë se vlera e përcaktuar në kontratë. Për më tepër, nga data 13.04.2017, ministria ka lidhur marrëveshje me OE për shfrytëzimin e kontratës së AQP-së[4], dhe me këtë kontratë janë bërë pagesa për bileta në vlerë prej 66,828€.

Shfrytëzimi i kontratës së AQP-së ka filluar pa përfunduar afati i kontratës individuale të MZHE-së me OE. Për më tepër në kontratën e AQP-së çmimi i shërbimit për njësi ishte 1.27€, që ishte më i lartë në krahasim më kontratën paraprake prej 0.00000000001cent[5] për njësi.

Rreziku

Tejkalimi i shpenzimeve të planifikuara dhe rrit rrezikun që shpenzimet të mos bëhen për qëllimet e ndërlidhura me objektivat e organizatës. Ndërsa shfrytëzimi i kontratës së AQP-së pa përfunduar afati në kontratën paraprake rrit rrezikun ndaj detyrimeve kontraktuale, po ashtu kontrata në këtë rast nuk ishte ekonomike dhe ndikon negativisht në arritjen e vlerës për para.

Rekomandimi 5

Ministri duhet të rrisë kontrollet për menaxhim të mirë të kontratave për shpenzime udhëtimi, po ashtu të siguroj një planifikim sipas nevojave reale dhe të arsyeshme, që shpenzimet e bëra për udhëtime të jenë në pajtim me arritjen e objektivave të ministrisë.

[4] AQP-Autoriteti Qendror i Prokurimit ka lidhur kontratë kornizë për shërbime të transportit ajror, të cilën mund ta shfrytëzojnë 84 organizata buxhetore

[5] Kjo vlerë (prej: zero pikë dhjetëzeroenjëcent) nuk ishte faturuar në faturat e blerjeve të biletave

Çështja 6 – Mos arsyetim i duhur për shpenzimet e udhëtimeve zyrtare

E gjetura

Sipas UA Nr.2004/07 referuar pikës 1- pas plotësimit të formularit për udhëtim zyrtar duhet të bashkëngjitet edhe arsyeshmëria me shkrim e miratuar nga udhëheqësi i nëpunësit civil si dhe agjenda e takimit zyrtar. Po ashtu nenet 3 dhe 8 të këtij UA përcaktojnë se kërkesat duhet të përmbajnë vlerën e mjeteve financiare të cilat duhet të arsyetohen më dëshmi të duhura për shpenzimet e udhëtimit zyrtar.

Lidhur me shpenzimet e udhëtimit kemi vërejtur se, në tri raste mungojnë faturat për shpenzimet e fjetjes[6]. Ndërsa në 11 raste mungon dëshmia e udhëtimit (boarding pass), si dhe arsyeshmëria e udhëtimit nuk ishte e duhur në shumicën e rasteve. Po ashtu formulari i kërkesës për udhëtim nuk është nënshkruar nga zyrtarja e personelit dhe nuk është përdorur formulari zyrtarë për llogaritjen e shpenzimeve për udhëtime zyrtare.

Për më tepër, udhëtimi zyrtar për në Turqi në vlerë prej 996€ ishte bërë për ish zyrtaren e ministrisë, e cila në ministri është e angazhuar me punë vullnetare pas moshës së pensionimit. Sipas rregullores nr. 20/2012 për punë vullnetare të nëpunësve civil, neni 7 përcakton përgjegjësitë e institucionit, me rastin e angazhimit në punë vullnetare të nëpunësve civil pas pensionimit, mirëpo mbulimi i këtyre shpenzimeve nuk parashihet.

Rreziku

Mungesa e dëshmive të udhëtimit dhe arsyeshmëria jo e duhur lidhur me udhëtimet zyrtare është ne kundërshtim me rregullat në fuqi dhe rrit rrezikun që shpenzimet e tilla nuk janë bërë për qëllimin e duhur. Po ashtu pagesa për zyrtarë me angazhim vullnetarë nuk ka mbështetje në rregullat ligjore.

Rekomandimi 6

Ministri duhet të rrisë kontrollet në këtë fushë dhe të siguroj se shpenzimet për udhëtime zyrtare bëhen në bazë të rregullave të përcaktuar dhe realizohen vetëm për qëllimet e duhura të ministrisë. Po ashtu të analizoj udhëtimet e ndodhura pa arsyeshmëri të mjaftueshme dhe të siguroj se praktika të tilla të mos përsëriten.

[6] Udhëtimi në Greqi me nr. të Urdhër Obligimit për Pagesë (UOP) 21317948, udhëtimi në Norvegji me nr. UOP 21317832 dhe udhëtimi në Zvicër me nr. UOP 213171045, (për këto lëndë/udhëtime mungojnë faturat e fjetjes/hotelit).

3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 8,148,682€, shpenzimi për 2017 ishte 8,058,013€. Prej tyre, vlera prej 8,022,682€ kryesisht është shfrytëzuar për mbulimin e shpenzimeve operative për ndërmarrjet publike. Ndërsa vlera prej 35,332€ janë dhënë më vendim të sekretarit apo ministrit sipas kërkesave.

Çështja 7 - Dobësi në vlerësimin dhe monitorimin e ndërmarrjeve publike

E gjetura Sipas nenit 28.3, të Ligjit Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrje Publike, Njësia për Politikat dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP), në bazë vjetore duhet vlerësojë efektshmërinë e drejtorëve të secilës Ndërmarrje Publike (NP) dhe këtë vlerësim të publikoj në faqe të internetit. Për vitin 2017 kjo njësi, nuk ka arritur të bëjë dhe të kryej/publikoj një vlerësim të tillë.

Po ashtu, ministria me secilën ndërmarrje publike përfituese të subvencioneve dhe investimeve kapitale, ka nënshkruar marrëveshje për monitorimin dhe kontroll lidhur me këto shpenzime. Marrëveshjet e nënshkruara nuk specifikojnë qartë se si duhet arsyetuar apo dokumentuar shpenzimet e ndara/ndodhura nga subvencionet.

Rreziku Mungesa e vlerësimit të efektshmërisë së drejtorëve të ndërmarrjeve publike dobëson llogaridhënien dhe është në kundërshtim me rregullat në fuqi. Ndërsa mos caktimi i qartë i kritereve për raportim mbi shpenzimin e subvencioneve rrezikon që mjetet e shpenzuara të mos arrijnë qëllimin e duhur.

Rekomandimi 7 Ministri duhet të siguroj monitorim adekuat mbi ndërmarrjet publike, menaxhim dhe kontroll të duhur për shpenzimet e subvencioneve, duke përcaktuar kritere të qarta për mënyrën e raportimit lidhur me këto shpenzime.

Çështja 8 – Arsyetim i pamjaftueshëm i subvencioneve

E gjetura Kompania Rajonale e Mbeturinave "Uniteti" ka lidhur marrëveshje me MZHE-në për mbështetje financiare sipas të cilës MZHE do të subvencionoj mbulimin e shpenzimeve për rastet minoritare (serb, rom, ashkali, boshnjak e turk) dhe pjesën në veri të Mitrovicës sipas regjistrit të konsumatorëve dhe brenda mundësive buxhetore.

Në bazë të kësaj marrëveshje, më kërkesë të Kompanisë janë bërë dy pagesa nga 30,000€ (në total 60,000€) në dt. 03.03.2017 dhe 20.07.2017. Me rastin e kërkesës, kompania ka ofruar lista të thjeshta me vendbanime ku jetojnë minoritetet, emra/mbiemra, dhe vlera mujore e ngarkesës financiare. Dokumentacioni i sjellur nga kompania nuk ofron dëshmi të mjaftueshme se këta persona janë klient aktiv të kompanisë të regjistruar në sistemin e saj (përfshirë numrin identifikues, numrin e kuponit pastaj faturimi për këta klient dhe në përgjithësi historiku i borxheve etj.)

Rreziku Mungesa e qartësisë/sigurisë mbi regjistrat e konsumatorëve lidhur me faturimet nga ndërmarrja publike, e vështirëson mbikëqyrjen nga ministria rreth transferit të mjeteve/ndihmës financiare. Kjo mund të ndikojë që paraja publike të mos shfrytëzohet për qëllimin e synuar dhe sjellë raportim jo të drejtë financiar të ministrisë.

Rekomandimi 8 Ministri duhet të siguroj kontrolle të duhura rreth monitorimit të subvencioneve, të kërkojë nga zyrtaret përgjegjës që të bëjnë një ekzaminim të dokumentacionit dhe subvencionet të jepen pasi të sigurohen se ato i shërbejnë qëllimit të synuar.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 11,433,064€ ndërsa shpenzimi është 11,122,636€. Shuma prej 4,822,299€ janë transfere kapitale për entitetet publike ndërsa pjesa tjetër është për investime në objektet publike. Në vijim do të prezantojmë dobësitë e identifikuara në këtë fushë:

Çështja 9 – Mos bartja e pronësisë me rastin e blerjes së pajisjeve/kamionëve

E gjetura Në kuadër të projektit nr. 12054 "Instalimi i pajisjeve filtruese dhe pajisjeve për përmirësimin e teknologjisë dhe kushteve të punës" për ndërmarrjen Trepça-veri MZHE kishte bërë pagesë nga transferet kapitale në vlerën prej 103,198€ (dt.09.08.2017). Transferi është bërë për blerjen e tre pajisjeve, një kamion transportues në vlerë 18,190€ (viti prodhimit 2011), një kamion në vlerë 63,720€ (viti prodhimit 2007) dhe një mjet ngarkues në vlerë prej 21,288€. Në bazë të dëshmive të marra nga ministria (NJPMNP), vërehet se pajisjet janë kontraktuar dhe sipas komisionit janë pranuar, mirëpo kemi identifikuar se dy kamionët nuk janë bartur në pronësi të Trepçës. MZHE ka ofruar kopjet e librezave të regjistrimit për këta kamion ku vërehet se ende janë në pronësi të shitësit (kompanisë private).

Rreziku Mungesa e monitorimit dhe kontrollit të transfereve kapitale në NP, rritë rrezikun që mjetet të mos shfrytëzohen për qëllimin e synuar dhe objektivat e projektit. Po ashtu mos bartja e pronësisë, nuk siguron se pasuria me të vërtetë i takon/përdoret nga organizata.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të siguroj monitorim efektiv për transferet kapitale për projektet në ndërmarrjet publike, me qëllim që ato të shpenzohen në përputhje me aprovimin e tyre. Po ashtu, të sigurohet se tranferet e mjeteve bëhën vetëm pas procedurave korrekte të blerjeve dhe bartjes së pronësisë së pasurisë.

3.7 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 10 - Lidhja e kontratës më procedurë jo adekuate

Sipas nenit 35.2 të LPP, lidhja e kontratës me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, mund të bëhet në rastet, kur për arsye teknike ekziston vetëm një operator i mundshëm ekonomik apo për shkak të ekzistimit të drejtave ekskluzive të autorit, në rastet e urgjencës ekstreme. Ministria ka nënshkruar kontratë në vlerë prej 5,474€, me datë 13.12.2017 për mirëmbajtjen dhe bartjen e inventarit të MZHE-së duke përdorur procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Ky lloj i shërbimeve nuk parashihet më nenin e lartë cekur të ligjit. Kjo ka ndodhur pasi procedura e hapur, është përcjellë me ankesa gjatë procesit të prokurimit dhe nuk është arritur që të shpallet fituesi.

Rreziku Përdorimi i procedurës jo adekuate të prokurimit përveç se nuk është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore, nuk promovon konkurrencën dhe rrit rrezikun që për shërbime të tilla të mos arrihet çmimi i tregut.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të siguroj kontrolle dhe menaxhim adekuat në fushën e prokurimit duke siguruar procedura adekuate të prokurimeve/kontraktimeve.

Çështja 11 – Tejkalim i vlerës së kontratës

E gjetura Neni 38 i ligjit nr. 04/L-042 i prokurimit publik (me plotësim ndryshimet, data 21.01.2016) përcakton mospërputhjen e lejuar të kontratës kornizë plus/minus 30% të vlerës së kontratës. Ne rast se tejkalohet 30%-shi, pa marr parasysh datën e skadimit të kontratës publike kornize, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

Për kontratën kornizë "Punimi i video raporteve nga takimet dhe aktivitetet në MZHE, për nevojat e web-faqes së Ministrisë dhe për shpërndarje mediave", e nënshkruar me date 08.03.2016 në vlerë 3,945€, vetëm në vitin 2017 janë paguar 5,860€ tejkalim prej 49% apo rreth 19% mbi kufirin e lejuar.

Rreziku Tejkalimi i kontratës kornizë është në kundërshtim me ligjet në fuqi, gjithashtu pasqyron dobësi në menaxhim të kontratave. Kjo rrit rrezikun që mjetet të mos përdoren për qëllimin e synuar dhe mund të ndikoj që ministria të hyjë në obligime financiare të paplanifikuara.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të siguroj kontrolle të duhura në fushën e prokurimit dhe menaxhim adekuat të kontratave publike me qëllim të realizimit korrekt të tyre dhe arritjes së vlerës për para.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Ministria e Zhvillimit Ekonomik gjatë vitit 2017 ka bërë një progres të dukshëm në aspektin e regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin paraprak. Përkundër progresit, ende nuk është arritur që regjistri kontabël i pasurive të jetë i plotë dhe i saktë. Lidhur me pasuritë kemi paraqitur një çështje në nën-kapitullin 2.1, të cilën ministria duhet ta ketë parasysh në vitin 2018, nuk kemi çështje tjera për të raportuar.

3.9 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2017 ishin 9,000€ deri sa në vitin 2016 ishin 64,000€. Pra, vërehet një ulje e obligimeve prej 55,000€. Këto obligime janë bartur për tu paguar në vitin 2018. Përveç çështjeve të paraqitura te nënkapitulli 2.1 nuk kemi ndonjë çështje për të raportuar.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Për rekomandimet tona për auditimin e vitit 2015 dhe 2016 MZHE ka përpiluar planet e veprimit për zbatim të rekomandimeve. Si pjesë e auditimit tonë, në vitin 2017 kemi vlerësuar se nga 10 rekomandimet e dhëna për vitin 2016, tre rekomandime janë zbatuar, tre pjesërisht dhe katër nuk janë zbatuar. Ndërsa prej pesë rekomandimeve të bartura nga viti 2015, një është zbatuar, tre janë ende në proces të zbatimit si dhe një nuk është zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 12 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura MZHE përkundër përpjekjeve për zbatimin e rekomandimeve, ende një pjesë e madhe e rekomandimeve mbesin të pa zbatuara. Si rrjedhojë e kësaj edhe gjatë këtij viti janë përsëritur mangësitë e njëjta si të viteve të mëhershme. Kjo më e shprehur ishte te përgatitja e PFV-ve, sistemi i NJAB, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere si dhe pasuritë.

Rreziku Mungesa e zbatimit të rekomandimeve ka ndikuar që dobësitë e njëjta në kontrollet menaxheriale dhe kontrollet tjera në sistemet kyçe financiare, janë përsëritur në vitin audituesdhe është rrezik që gjendja e tillë të vazhdoj ende.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të analizoj arsyet e moszbatimit të rekomandimeve paraprake dhe siguroj se plani i veprimit i rishikuar i adreson të gjitha dobësitë dhe i nënshtrohet monitorimit të rregullt nga menaxhmenti.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në lidhje me qeverisjen e mirë ne vlerësojmë progresin që ka bërë MZHE në hartimin e listës së rreziqeve si dhe planin e veprimit për menaxhimin e rrezikut. Edhe pse MZHE ka hartuar Planin Strategjik Zhvillimor për vitet 2017-2020 duke caktuar katër objektiva kryesore, kjo paraqet vetëm një hap për një qeverisje të mirë. Këtij plani duhet shtuar veprimet për zbatim.

Një numër i dobësive të qeverisjes brenda MZHE –se u cekën më lartë në lidhje me moszbatimin e plotë të rekomandimeve nga vitet paraprake, po ashtu duhet shtuar edhe mungesën e një plani të qartë te shpenzimeve lidhur me projektet kapitale, si transfere kapitale për entitet publike.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB), përbëhet nga dy auditore, drejtori/udhëheqësja e njësisë dhe një auditore. NjAB kishte planifikuar katër auditime nga këto kishte kryer vetëm dy auditime.

Komiteti i Auditimit kishte mbajtur mbledhje të rregullta tre mujore, ku janë diskutuar zbatimi i rekomandimeve dhe mangësitë në menaxhimin e NjAB duke rekomanduar menaxhmentit që të marrë veprime. Dobësitë e identifikuara në këtë fushë janë si në vijim:

Çështja 13 - Dobësi në funksionimin e NJAB

E gjetura

Sipas ligjit nr. 03/L-128 për Auditim të Brendshëm, plani vjetor dhe strategjik i auditimit të brendshëm duhet të dorëzohet tek Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm (NJQHAB), jo me vonë se 31 tetor të secilit vit kalendarik pas miratimit nga menaxhmenti i lartë dhe komiteti i auditimit. Po ashtu NJAB është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve tremujore dhe vjetore për të gjitha aktivitetet e auditimit në NJQHAB-së.

Edhe gjatë viti 2017, menaxhimi dhe puna e NJAB ishte përcjellë me dobësi.

- Miratimi i planit vjetor dhe azhurnimi i planit strategjik është bërë dy muaj me vonesë (05.01.2017);
- Në planin vjetor i auditimit janë planifikuar katër auditime ndërsa vetëm dy janë përfunduar;
- NJAB për vitin 2017, ka raportuar vetëm për tremujorin e parë në NJQHAB; dhe
- Auditimet e përfunduara edhe pse në planifikim janë cilësuar si auditime me rrezik të lartë, nuk kanë reflektuar të tilla. Auditimi "Trajtimi dhe identifikimi i detyrimeve të vitit 2016", ka përfunduar me dt. 27.03.2017, përderisa në planin e veprimit drejtoria e financave ka deklaruar se detyrimet janë shlyer në muajin shkurt. Gjithashtu te auditimi "Monitorimi i bordeve të drejtorëve të ndërmarrjeve publike qendrore", është ndryshuar objektiva e auditimit, duke kryer auditimin e "Sistemit të menaxhimit të njësisë për monitorimin të ndërmarrjeve publike".

Rreziku

Dobësitë e identifikuara janë reflektuar nga planifikimi joadekuat i objektivave të auditimit, gjë që zvogëlon sigurinë e ofruar tek menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve kyçe financiare. Gjithashtu, kjo mund ndikojë edhe në mos identifikimin e dobësive eventuale dhe me vazhdimin e praktikave joefektive.

Rekomandimi 13

Ministri duhet të merr masa të menjëhershme që të siguroj funksionimin efektiv të NJAB me qëllim që përftimet nga kjo njësi të jenë maksimale duke kontribuar në funksionimin e duhur të kontrolleve të brendshme.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Procesi i raportimit të brendshëm në MZHE funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe sipas ligjit dhe strukturës organizative. Lidhur me ketë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjithë drejtuesit e departamenteve, ku pjesëmarrës shpeshherë është edhe ministri duke diskutuar raportet dhe çështjet tjera për të gjitha aktivitetet e saj. Departamentet raportojnë në baza javore në lidhje me aktivitetet e tyre. Megjithatë, nuk ka informacione dhe monitorim për arritjet e objektivave te organizatës e cila ishte vet-vlerësuar me pike të dobët në raportin e vetëvlerësimit nga vetë organizata.

Çështja 14 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut/projekteve

E gjetura Ministria gjatë vitit 2017 nuk kishte arritur që të ushtroj mjaftueshëm kontrollet menaxheriale. Ne kemi identifikuar dobësitë në vijim:

- Sipas rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), MZHE duhet të ketë një regjistër të rreziqeve. Megjithëse regjistri i rreziqeve është hartuar, përmbajta e tij nuk menaxhohet në mënyrë aktive sa i përket azhurnimit dhe sigurimit se janë ndërmarrë veprime për të zbutur rreziqet. Ne kuadër të raportit të vet-vlerësimit shihet se MZHE ka ende dobësi. Në komponentin 4 - Informimi dhe Komunikimi për tetë pyetje përgjigjet ishin dhënë negative.
- Me dt. 20.10.2017 është paguar shuma prej 498,986€ në emër të furnizimit me pajisjen SEM për laboratorin e Gjeologjisë së Kosovës. Me 18.10.2017 komisioni prej tre anëtarëve kishte bërë pranimin fizik por jo edhe testimin e saj pasi ministria ende nuk ka siguruar lokacionin e vendosje se këtyre pajisjeve. Ne kemi ekzaminuar fizikisht pajisjen në maj 2018, e cila ende ndodhet e paketuar/ambalazhuar. Ministria është duke u përpjekur të siguroj lokacion/objekt për këto pajisje (në koordinim me institucionet tjera), por ende nuk ka arritur të siguroj.

Rreziku Vet-vlerësimi i aktiviteteve me përgjigje negative jep sinjal që kontrollet në menaxhimin financiar nuk mund të parandalojnë gabimet në fushat e caktuara. Gjithashtu blerja e pajisjeve pa u siguruar paraprakisht lokacioni rezulton që pajisja te qëndroj e pa shfrytëzuar dhe jo e dobishme për nevojat përkatës, ndërsa shpenzimi i bërë nuk ka arritur qëllimin e duhur.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të sigurojë veprime konkrete për përmirësimin e pikave të dobëta në kudër të vet-vlerësimit, të siguroj se të gjitha pagesat për projekte kanë arritur qëllimin e duhur dhe të siguroj se blerja e pajisjeve bëhet në bazë të planeve/nevojave të ministrisë, duke siguruar fillimisht lokacion/objekt.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që në vazhdimësi mbanë llogaridhënës personat përgjegjës të përcaktuar në planin e veprimit me qëllim të implementimit të rekomandimeve të AP-së sipas afateve kohore të përcaktuara me plan.		Prej pesë rekomandimeve te bartura në vitin 2017, është implementuar vetëm një deri sa dy janë ne proces dhe dy të tjera nuk janë zbatuar.	
2.4. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Ministri duhet të iniciojë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të MZHE-së, përcjellë me koston financiare që mund të ndikojë në arritjen e objektivave të synuara duke u bazuar në strategjinë e përgjithshme të qeverisë. Po ashtu, duhet të ndërmerr veprime për adresimin e fushave me dobësi të identifikuara në listën kontrolluese të vetëvlerësimit.		Ne bazë te listës kontrolluese te vetëvlerësimit ende nuk janë marre masa ne zbatimin e te gjitha fushave. Rishikimi i kësaj liste ka rezultuar pjesërisht kane pasur zbatim te këtij rekomandimi.	
2.5.1 Sistemi i Auditimit te brendshëm	Ministri duhet të analizojë arsyen e përgatitjes me kohë dhe në mënyrë cilësore të planit vjetor dhe mos kryerjen e auditimeve nga NjAB-i si dhe të ndërmarrë masa për funksionalizimin e NjAB-it si pjesë e rëndësishme e kontrollit të brendshëm.			Nuk janë marrë veprime
3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të sigurojë që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave kanë vendosur të gjithë zyrtarët e punësuar që kanë marrëdhënie të rregullt pune në listën e pagave gjithnjë duke pasur parasysh numrin e aprovuar me ligjin e buxhetit.		Deri në tetor 2017 nuk janë ndërmarrë veprime, përmirësimet kanë rrjedhur me ndërrimin e stafit në kabinetin e ministrit	

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV dhe kërkesat tjera për raportim	Ministri duhet të sigurojë se buxhetimi dhe klasifikimi i projekteve analizohen mirë dhe që ato duhet t'i takojnë kategorisë adekuate për të shmangur keq klasifikimin. Më tutje, Ministri duhet të siguroj raportim të saktë të pasurive jo kapitale nën 1,000€.			Nuk janë marrë veprime
2.1 Zbatimi i rekomandimeve te vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për adresimin e tyre. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe dhe zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.		Pjesërisht janë marre veprime për zbatim, pasi ende nuk janë zbatuar të gjitha rekomandimet	
2.2 Pyetësori i vet-vlerësimit te komponentëve te MKF-se	Ministri duhet të sigurojë hartimin e planit për menaxhimin e rrezikut bazuar në rreziqet e identifikuara dhe të sigurojë raportim të rregullt për zbatimin e kërkesave në këtë fushë duke monitoruar menaxhimin e rreziqeve në vazhdimësi.		Pjesërisht pasi plani është përgatitur, por ende nuk ka ndonjë raportim i rregullt për zbatimin e këtij rekomandimi.	
2.3 Sistemi i auditimit te brendshëm	Ministri duhet të analizojë shkaqet e mosfunksionimit efektiv të NjAB-së dhe të ndërmerr veprimet që ndikojnë në eliminimin e pengesave në mes të akterëve relevant, duke funksionalizuar NjAB-në si një komponent shumë i rëndësishëm i kontrollit të brendshëm			Nuk janë marrë veprime
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri, duhet të siguroj se është bërë një vlerësim i arsyeve në lidhje me pengesat e hasura në procesin e realizimit të këtij projekti, si dhe të nxjerrin mësimet në mënyrë që praktikat e tilla të mos përsëriten. Në rastet e financimeve nga huamarrja ose forma tjera të bashkëfinancimeve duhet të përcaktohen qartë kërkesat për menaxhimin e projekteve.	Është zbatuar		

3.1.1 Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të sigurojë se respektohet korniza ligjore në lidhje me numrin e stafit të lejuar me buxhet dhe të gjithë zyrtarët që kanë kontrata të rregullta duhet të paguhen nga lista e pagave.		Deri në tetor 2017 nuk janë ndërmarrë veprime, përmirësimet kanë rrjedhur me ndërrimin e stafit në kabinetin e ministrit	
3.1.2 Mallrat dhe Shërbimet si dhe shpenzimet komunale	Ministri duhet të siguroj se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë efektive dhe parandalojnë çdo parregullsi para se të ndodhë pagesa. Një monitorim i vazhdueshëm i efektivitetit të kontrolleve të vendosura mund të sigurohet edhe nga NjAB-i.	Është zbatuar		
3.1.3 Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë se çdo pagesë për subvencion ka marrë aprovimin paraprak nga NjPMNP dhe është në përputhje të plotë me marrëveshjen e nënshkruar për monitorim.			Nuk janë marrë veprime
3.1.4 Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit se kriteret e vendosura janë në përputhje të plotë me LPP-në dhe të specifikohen qartë dëshmitë që mund të përmbushin kriteret e përcaktuara.	Është zbatuar		
3.2 Pasurit	Ministri duhet të sigurojë që menaxhimi i regjistrave të bëhet komfor rregullave të përgjithshme për menaxhimin e pasurive, përkatësisht të sigurojë funksionalizimin e sistemit e-pasuria. Po ashtu, Ministri duhet të ndërmerr veprime që të krijohen kushtet që pajisjet për laboratorin e gjeologjisë të hyjnë në funksion.			Nuk janë marrë veprime

Shtojca III: Komentet e OB-së në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	**Pajtohemi po/jo**	**Komentet e OB-së në rast të mospajtimit**	**Pikëpamjet e ZKA-së**
Rekomandimi 1	Pjesërisht pajtohem	NJPMNP çdo herë ka bërë përcjelljen e lëndëve të NP-ve, ku dhe ka siguruar dokumentacionet e nevojshme përmes të cilave ka siguruar menaxhimin e mire dhe kontroll që pagesat për transfere kapitale dhe subvencione të realizohen dhe brenda afateve të planifikuara në klasifikimin e duhur të shpenzimeve (pagesave), në kodet ekonomike Subvencion apo Transfer Kapital, ashtu siç dhe janë planifikuar në këto kode ekonomike.	Komenti apo shpjegimi i MZHE nuk ndryshon të gjeturën/rekomandimin.
Rekomandimi 2	Pjesërisht pajtohem	Detyrimet kontigjente nuk mund të trajtohen nëse për të njëjtat nuk ka një vendim gjyqësor apo në rastin aktual pretendenti-Posta e Kosovës të zbatojë në tersi marrëveshjen dhe plotësimin e kushteve për kompensim të shpenzimeve për ushtrim të shërbimit të rezervuar postar. Në rastin konkret Posta e Kosovës nuk ka plotësuar asnjërin nga kushtet e parapara dhe për këtë qëllim MZHE nuk ka mundur që pretendimin ta trajtojë si "obligim kontingjent" dhe të njëjtin ta paraqesë' në Pasqyrat Financiare të vitit 2018. Gjithashtu, konstatimet për gjashtë (6) padi të tjera, nga të dhënat e marra nga Avokatura Shtetërore, vetëm tre (3) prej tyre janë raste që kanë të bëjnë me MZHE-në, ndërsa paditë të tjera janë adresuar për ndërmarrje publike dhe vendim i atakuar për OSHP. Andaj, si rrjedhojë e kësaj, nuk mund të parashihet shpalosje e vlerësimit të riskut si dhe prezantim në PVF, rastet të cilat nuk janë ndaj MZHE-së, si konteste apo si detyrime kontingjente.	Sipas rregullores 01/2017, detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen. Sipas standardeve të kontabilitetit, detyrimet kontingjente shfaqen nëse ekziston mundësia, por nuk është mjaft e besueshme që detyrimi të ekzistojë, ose shuma nuk mund të vlerësohet në mënyrë të sigurtë. Për rastin e PTK-së, është një dokument i protokolluar me datën 19.06.2017 i dorëzuar tek Thesari ne emër të Përmbaruesit për borxhin që ka MZHE ndaj PTK-së dhe një ankesë e Avokatit Shtetëror ndaj pretendimit të PTK-së. Po ashtu janë gjashtë raste tjera siç janë paraqitur në raportin e auditimit.

			Neni 18 i Rregullores se MF 01/2017 përcakton se organizatat buxhetore në harmoni LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente. Ndërsa LMFPP parasheh të bëhet një vlerësim i të gjitha detyrimeve kontigjente, duke përfshirë një vlerësim të riskut. Andaj e gjetura dhe rekomandimi nuk ndryshojnë.
Çështja 3: Rekomandimi 3	Pjesërisht pajtohem	Ministria e Zhvillimit Ekonomik gjatë vitit 2017 ka bërë një progres të dukshëm në aspektin e regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin paraprak. Gjithashtu korrigjimi i pasqyrave Financiare ka ndodhur me date 22.02.2018 ku është korrigjuar shënimi 10 tek të hyrat jo tatimore, si të hyra nga licenca dhe të cilat janë realizuar si të hyra për autorizimin dhe ekzaminimin e "Enëve nen Presion", për palët e autorizuara nga MZHE ne shumë prej 2,100 Euro. Pasi të hyrat nuk janë paraqitur ne Raportin Financiar për nëntëmujorin 2017 dhe Raportin Vjetor Financiar të dorëzuar me 30 Janar 2018, ky ndryshim është bere me korrigjimin e PFV. Ndryshimet kane ndodhur dhe tek Neni 13 dhe Neni 14 ne PFV ne kodin mallra dhe shërbime ne vlere prej -114.93 Euro. Andaj, edhe sikur se është potencuar ne këtë raport nga ana juaj, konsiderojmë qe pasqyrat paraqesin gjendjen reale dhe të drejtë duke pasur ne konsideratë atë qe u potencua ma lartë.	Komenti i ministrisë më tepër shpjegon kronologjinë e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe progresin në regjistrimin e pasurive, ndërsa e gjetura jonë dhe rekomandimi ndërlidhet me mos regjistrimin e investimeve në vijim dhe mos prezantimin e tyre në pasqyra në pasqyra financiare. Andaj e gjetura dhe rekomandimi nuk ndryshojnë.

Çështja 4: Vazhdimi i kontratës pa bazë të qartë rregullative	Pjesërisht pajtohem	Konstatimet ne çështje për rastin konkret nuk qëndrojnë, sepse : Neni 13.8, i LPP ka hyrë në fuqi me 16.04.2018, kurse procedura është zhvilluar dhe kontrata është nënshkruar në vitin 2014, ku kjo kontratë deri në përfundim vazhdon me ligjet në fuqi kur janë zhvilluar procedurat për këtë kontratë, kjo sqarohet ne dispozitat përkatëse të legjislacionit, me ligjin aktual. Vlen të ceket se në dosje të tenderit dhe në kontratë është opsioni i vazhdimit ku jeni informuar dhe ua kemi dërguar në mënyrë elektronike dhe fizike. Sa i përket nenit 3.6 që e përjashton punësimin, kjo kontratë nuk është punësim, por angazhim i konsulentit për shërbime këshillëdhënëse për nevoja përkatëse sipas vendimit te qeverisë dhe kemi vepruar sipas vendimi të Qeverisë së Kosovës nr. 08/17 të datës 01/06/2011 neni 4. Gjithashtu, këto dy kontrata janë nënshkruar në vitin 2014, vazhdimi i tyre është bërë në vitin 2016, kurse ZKA ne auditimin e pasqyrave për vitin 2016 nuk ka pasur vërejtje ne këtë drejtim. Në të njëjtën kohë, siç edhe jeni të informuar, për lejimin e nënshkrimit të këtyre kontratave ka pasur edhe një vendim të Organit Shqyrtues të Prokurimit, i datës 15.04.2014 ku i lejohet AK që të vazhdojë me procedimin e kësaj lënde dhe të nënshkruhet kontrata.	Ne i jemi referuar Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit të cilat ishin në fuqi në kohën e nënshkrimit të kontratës, e jo LPP-së. E gjetura jonë ndërlidhet me ndjekjen e duhur të procedurave të prokurimit dhe përgatitjen e kontratës. Me faktin se ministria në njoftimin për kontratë nuk e ka parashikuar opsionin/mundësinë e vazhdimit, po ashtu në kontratë janë disa elemente të kontratës se punësimit. Dëshmitë e sjellura, vendimi i qeverisë dhe vendimi i OSHP-së lidhur me një ankesë të OE, nuk kanë të bëjnë me të gjeturën andaj edhe e gjetura dhe rekomandimi nuk ndryshon.
Çështja 5: Kontrata për shpenzimet e biletave të udhëtimit	Nuk pajtohem	Sipas pikës 13.1 të udhëzuesit operativ të prokurimit publik, vlera e parashikuar e një kontrate publike parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Në këtë rast vlera e parashikuar ne kontratë (30.000 €) është paraparë për vitin 2015, kur edhe është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik. Ndërsa, për vitin 2016 shpenzime të udhëtimit kanë qene të planifikuara 205.245.00€. Për vitin 2017, 214.637,00€. Kjo përllogaritje bëhet gjithmonë duke u mbështetur në shpenzimet e krijuara ne vitin paraprak dhe planifikimet e agjendat zyrtare për vitin që vjen. Gjithashtu, për këtë kontratë duhet ta keni parasysh se asnjëherë nuk mund të bëhen parallogaritje të sakta, për arsye se çmimet e biletave të aeroplanit nuk janë fikse si dhe planifikimet për udhëtime nuk mund të dihen gjithmonë saktë. Ashtu ka ndodhur edhe në vitin 2017 ku shume udhëtime janë realizuar pa planifikim paraprak dhe me urgjencë.	Çështja jonë ndërlidhet me kontratën e nënshkruar me OE dhe vlerën e parashikuar në kontratë. Ne jemi bazuar në nenin 3.1 të kontratës, që thotë 30,000€ për vit, që nënkupton për 3 vitet sa ishte kontrata në fuqi. Ndërsa shfrytëzimi i kontratës së AQP-së është kërkuar pas përfundimit të kontratës individuale me OE.

		Sa i përket çështjes se kalimit në kontratën e AQP-së ende pa përfunduar afati i kontratës individuale, është e vërtete se MZHE ka pasur kontratë kornizë individuale 36 mujore, mirëpo pas përmbushjes së kontratës në sasi dhe vlerë ajo është përmbyllur dhe automatikisht sipas vendimit të Qeverisë kemi qenë të obliguar të shfrytëzojmë kontratën e AQP-së, kushtet e së cilës janë përcaktuar nga ajo kontratë, gjithashtu edhe çmimi i shërbimit për njësi 1.27€.	Çështja e vendosur në raport nuk ndryshon pasi e gjetura ndërlidhet me Kontratën Kornizë për shpenzimet për biletat e udhëtimit. Andaj e gjetura dhe rekomandimi nuk ndryshojnë.
Çështja 6: Mos arsyetimi i duhur për shpenzimet e udhëtimeve zyrtare	Pjesërisht pajtohem	Udhëtimi në Greqi, në lëndë është fatura e hotelit nr. AA:55482, në vlerë prej 273 euro ndërsa në të njëjtin udhëtim (rast) pala ka udhëtuar edhe në Kroaci por që në këtë rast shpenzimet e fjetjes janë mbuluar nga organizatori dhe palës nuk i janë paguar dhe as llogaritur ky lloj i shpenzimit. Dëshmi: Komplet lënda e udhëtimit në Greqi dhe në Kroaci: KP 94399Udhëtimi në Zvicër, gjithashtu ka Faturën e hotelit "POSTHORN" në vlerë prej: 775 CHF dhe të dhëna të sakta për kohën e qëndrimit të palës që ka udhëtuar. Dëshmi: komplet lënda e pagesës së shpenzimeve të udhëtimit përkatës: KP 2017-175609 Udhëtimi në Norvegji, ka faturën e shpenzimeve të akomodimit, për këtë udhëtim, që pala ka paguar në emër të "AIRBNB" Nr. 3/4Q/2017, në vlerë prej: 1430 euro për qëndrim nga dt. 02/shtator/2017 deri 13/shtator/2017. Dëshmi: Lënda KP; 2017-225424. Sa përket (boarding pass) dhe arsyeshmërisë se udhëtimit, si dëshmi, çdo lende ka biletën dhe arsyeshmërinë të bashkangjitur. Ju konfirmojmë se pas pranimit të draft raportit tuaj, jemi duke përmbushur këtë kërkesë për (boarding pass), e cila nuk ka qene kërkesë për palët qe kanë udhëtuar jashtë vendit me aeroplan . Çështja e udhëtimit të zyrtarit që nuk është punëtor i rregullt i MZHE-së nuk mund të trajtohet si shkelje pasi që në marrëveshjen për punë pas pensionit MZHE ka marrë përsipër mbulimin e të gjitha shpenzimeve që lidhen me aktivitetet dhe kushtet e punës. Bashkëlidhur marrëveshjen për punë pas pensionimit. Mos nënshkrimi i dokumentit të udhëtimit zyrtar nga zyrtari i personelit zakonisht është praktikuar vetëm të rastet kur udhëtimi ka te bej për pjesëmarrje ne trajnime apo workshope qe ndërlidhen me aktivitet sektoriale te	Komentet e bëra për udhëtimin në Greqi dhe Norvegji nuk janë relevante, pasi nuk ndërlidhen me mostrat në raport (ne kemi testuar dy udhëtime tjera të specifikuara në raport me nr. të Urdhër obligimit për blerje). Ndërsa për udhëtimin në Zvicër, është sjellë një dokument i cili nuk është faturë, por konfirmim i rezervimit. Po ashtu ministria ka pohuar se tani e tutje janë duke kërkuar boarding pass për secilin udhëtim. Lidhur me udhëtimin e punëtorit i cili nuk është punëtor i rregulltë i MZHE, qëllimi i udhëtimit nuk ndërlidhej me detyrat për të cilat është angazhuar në ministri. Andaj komentet dhe dëshmitë nuk janë relevante dhe arsyetimet e ministrisë nuk e ndryshojnë çështjen tonë.

		Ministrisë. Tani kemi formularin e ndryshuar nga MF dhe nuk përfshin nevojën për nënshkrim nga zyrtari i personelit.	
Çështja 7: Dobësi në vlerësimin dhe monitorimin e ndërmarrjeve publike	Pjesërisht pajtohem	NjPMNP, në mungesë të kapaciteteve për të vlerësuar efekteshmërin e Drejtoreve te Bordeve, ka bërë përpjekje për të arrit këtë duke iniciuar kërkesën për kontraktim të kompanive të jashtme ne vlerësimin e efektshmerisë se drejtoreve të Bordeve ne NP, por ne mungesë të buxhetit nuk ka mundur të realizohet. Ndërsa marrëveshjet specifikojnë kërkesat e domosdoshme për realizim të shpenzimit te subvencioneve te ndara përmes ligjit të buxhetit dhe si te tilla realizohen. Sa përket mënyrës dhe materializimit te dokumenteve është përgjithësi ligjore e vete NP-ve dhe ne si NJPMNP s'kemi të drejt të ndërhymë ne pjesën menaxheriale sipas ligjeve ne fuqi.	Ne kemi vlerësuar se kërkesat për arsyetimin e subvencioneve janë të dobëta në Marrëveshje, si rrjedhojë kemi gjetur parregullsi në këtë fushë. Andaj e gjetura dhe rekomandimi nuk ndryshojnë.
Çështja 8: Arsyetimi i pamjaftueshëm i subvencioneve	Pjesërisht pajtohem	Bazuar në ndarjet buxhetorë në kodin e ujerave dhe mbeturinave, MZHE gjatë 2017 ka ndare mjete financiarë për ndërmarrjen publike KRM Uniteti sh.a . Këto mjete ishin të destinuara për mbulimin e shpenzimeve operative të shkaktuara nga mos pagese së faturave nga komuniteti minoritar në terë regjionin ku operon ndërmarrja. MZHE nuk bën pagesën e faturave të pa paguar nga konsumatorët te ndërmarrje. Nisur nga kjo edhe nuk i kemi kërkuar faturat nga NP si dëshmi, por vetëm listën e familjeve që faturohen në bazë të së cilës edhe kalkulohet subvencioni.	Ne kemi vlerësuar se arsyetimi i subvencioneve ishte i pamjaftueshëm. Andaj e gjetura dhe rekomandimi mbesin të njëjta.
Çështja 10: Lidhja e kontratës me procedure jo adekuate	Nuk pajtohem	Me çështjen 10 nuk pajtohemi sepse neni 35 i LPP citat: Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës për të ushtruar aktivitetin e prokurimit vetëm në përputhje me këtë nen. KRPP-ja, në përputhje me nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.3 të këtij ligji, duhet të njoftohet nga autoriteti kontraktues në fjalë Brenda dy (2) ditëve nga data kur vendimi për përdorimin e procedurave të tilla është marrë. Autoriteti kontraktues duhet që në njoftim të ofrojë një shpjegim të hollësishëm të fakteve të konsideruara dhe justifikim për përdorimin e procedures. Bazuar në këtë ne ju kemi përmbajtur 100% LPP-së dhe atë nenit 35 paragarfi. Neni 35.2 i	Lloji i shërbimit (mirëmbajtja dhe bartjen e inventarit të MZHE-së) siç e kemi paraqitur në raport, nuk parashihet të zhvillohet përmes nenit 35 të LPP. Andaj e gjetura dhe rekomandimi qëndrojnë.

		LPP-se nuk është vetëm për procedurë një operator por është edhe për disa operator dhe atë: Neni 52.8 1 RRUOP-it: Kur autoriteti kontraktues vendos që t'i zhvilloj negociatat me më shumë së një operator ekonomik, negociatat do të zhvillohen sipas dispozitave të Neneve 51.15 - 51.22 të këtyre rregullave në këtë rast ne kemi dërguar ofertat 5 operatorëve ekonomik ku edhe jeni te informuar me rastin e auditimit të kësaj lende. Për informacionin tuaj çmimi është me i ulet se kontrata e publikuar me afat ligjor. Sa i përket këtij lloj të shërbimeve të konstatuar nga ju se kjo procedurë nuk parashihet nuk qëndron sepse është procedurë e LPP-se neni 35. Ju informoj se njoftimi për këtë procedurë është bere me datën 06.12.2017 ne KRPP me formularin 50 ku monitorimin e kryen Departamenti për monitorim qe e ka për obligim ligjor nëse nuk është konform LPP-se për refuzim dhe mos aprovim, dhe ne nuk kemi pas asnjë vërejte procedurale.	
Çështja 11: Tejkalimi i vlerës kontratës	Nuk pajtohem	E gjetura e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në pikën 13 nuk përputhet me gjendjen faktike. Kjo për faktin se OE 'Ekonomia Online' për periudhën raportuese ka pasur dy kontrata për shërbime të ndryshme me MZHE, kontratën Kornizë "Punimi i video Raporteve nga takimet dhe aktivitetet MZHE për nevojat e web faqes së Ministrisë dhe për shpërndarje mediave" në vlerë prej 3.945,00 Euro dhe Kontratë për Publikime (25.08.2015) me afat dyvjeçar me vlerë totale 15.840,00 euro. Andaj me rastin e auditimit, Auditori në fjalë ka raportuar të dy linjat e shpenzimeve si shpenzime të një kontrate çka përbën raportim të gabuar prej 6.230,00 € . Këto shpenzime janë për të dy kontratat e O.E në fjalë. - Kurse LPP-ja me ndryshime ka hyrë në fuqi me datë 21.01.2016, por edhe pas kësaj janë evidentuar disa mangësi dhe hyrja e fundit e LPP-së me ndryshime është me datën 01.03.2016, dhe nuk qëndron fakti se LPP me ndryshimet në fjalë ka hyrë ne fuqi me datën 06.01.2016 siç e keni apostrofuar ju në raport. E gjetura e çështjes së 11 nuk qëndron sepse këtu nuk kemi të bëjmë me kontratë kornizë siç pretendon auditori, por kemi	Ministria ka sjellë dy kontratat me OE të njëjtë, mirëpo nuk ka sjellë dëshmi rreth pohimit se pagesat i takojnë dy kontratave. Për vlerën e pagesës të paraqitur në raport i posedojmë dëshmitë se janë kryer përmes një kontrate (Punimi i video Raporteve nga takimet dhe aktivitetet MZHE për nevojat e web faqes së Ministrisë dhe për shpërndarje mediave). Sa i përket llojit të kontratës, në njoftimin për kontratë, pika II.1.3 Njoftimi përfshinë, Krijimin e kontratës publike kornizë. Gjithashtu edhe neni 3.3 i kontratës e përcakton, se kjo është

		të bëjmë me kontratë publike me procedurë të Koutimit të Çmimit.	një kontratë kornizë. Andaj e gjetura dhe rekomandimi nuk ndryshojnë.
Çështja 12: Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm	Nuk pajtohen	Ashtu si është cekur ne piken 3.9, të këtij draft raporti, për pasuritë kapitale dhe jo-kapitale se Ministria e Zhvillimit Ekonomik gjatë vitit 2017 ka bërë një progres të dukshëm në aspektin e regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin paraprak, andaj ne vitin 2018 do te paraqesim regjistrin kontabël te pasurive të jetë i plotë dhe i saktë. Korrigjimi i pasqyrave Financiare ka ndodhur me date 22.02.2018 ku është korrigjuar shënimi 10 tek të hyrat jo tatimore, ku janë paraqitur si të hyra nga licenca dhe të cilat janë realizuar si të hyra për autorizimin dhe ekzaminimin e "Enëve nen Presion", për palët e autorizuara nga MZHE ne shumë prej 2,100 Euro. Pasi të hyrat nuk janë paraqitur ne Raportin Financiar për nëntëmujorin 2017 dhe Raportin Vjetor Financiar të dorëzuar me 30 Janar 2018, ky ndryshim është bere me korrigjimin e PFV. Ndryshimet kane ndodhur dhe tek Neni 13 dhe Neni 14 ne PFV ne kodin mallra dhe shërbime ne vlere prej -114.93 Euro. Andaj, edhe sikur se është potencuar ne këtë draft raport nga ana juaj, konsiderojmë qe pasqyrat paraqesin gjendjen reale dhe të drejtë duke pasur ne konsideratë atë qe u potencua ma lartë.	Komenti i ministrisë shpjegon kronologjinë e përgatitjes se PF dhe progresin e bërë. Ndërsa ne kemi folur për rekomandimet e pazbatuara të cilat në detaje janë paraqitur në tabelën e shtojcës II të këtij raporti. Gjendja e rekomandimeve të pa zbatuara rrjedh nga gjendja faktike në organizatë. Andaj rekomandimi dhe e gjetura nuk ndryshojnë.
Çështja 13: Dobësi ne funksionimin e NJAB	Pjesërisht pajtohem	Mos hartimi i planit vjetor dhe strategjik me kohe ka ardhur si rezultat i shkaqeve subjektive shëndetësore këtë vite edhe pse ishte ne afate hartimi i tyre. Gjithashtu mos realizim i planit vjetor të NJAB-ës është bërë për shkak të kapaciteti të vogël të stafit të NJAB-ës, përkundër përpjekjeve te vazhdueshme për shtim te numrit te punësuarve ne NJAB. Ne vazhdimësi janë adresuar nevojat ne kërkesat buxhetore për shtim të masës për të punësuar për me shume se 3 vite ne vijimësi nga NJAB dhe Menaxhmenti i lartë. Po ashtu edhe në Kornizën Afatmesëm të Shpenzimeve (KASH) 2019, është parashtruar kërkesa por deri me tani kemi rezultuar pa suksesshëm me shtim buxheti tek MF.	Ministria ka komentuar arsyet rreth gjendjes aktuale në NJAB. Po ashtu ka sjellur dëshmi rreth veprimeve/kërkesave që ZKF ka bërë tek Ministri i Financave në vitin 2018 për shtimin e numrit të auditorëve në këtë njësi. Por këto nuk e ndryshojnë gjendjen e paraqitur në raport. Andaj çështja dhe rekomandimi për NJAB qëndron dhe nuk ndryshon.
Çështja 14: dobësi ne	Pjesërisht	Pagesa për pajisjen SEM, laboratorin e Gjeologjisë, ne shumën prej 498,986€ në emër të furnizimit me pajisje për laboratorin e Gjeologjisë së	Ministria ka shpjeguar procesin dhe gjendjen duke pohuar se pajisja është

kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut/projekteve		Kosovës. Për këtë pajisje komisioni prej tre anëtarëve kishte bërë pranimin fizik por jo edhe testimin e saj ne pamundësi ende për të siguruar lokacionin më të përshtatshëm për vendosje të këtyre pajisjeve. Sa i përket konstatimit, mos përdorimi i pajisjeve të blerë rezulton se nevoja për atë pajisje nuk ishte e domosdoshme dhe shpenzimi i bërë nuk ka arritur qëllimin e duhur. Konstatimet e tilla nuk i përkon me realitetin, sepse bazuar në Ligjit Nr.06/L-039 në neni 5, janë të përcaktuara Detyrat dhe përgjegjësit e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës të aprovuare në kuvendin e Republikës së Kosovës dhe pajisjet e tilla për laboratorin e SHGJK-së janë domosdoshmëri e kohës për ofrimin shërbime cilësore për kryerjen e studimeve të nevojshme, analiza laboratorike, të gjitha këto për nevoja të institucioneve vendore dhe bizneseve të cilat në një forme krijojnë kushte për ofrimin e shërbime dhe zhvillim ekonomik të vendit. Pas pranimit të pajisjes në mungesë të hapësirës adekuate, nga prodhuesi kemi rekomandime dhe sugjerime te fuqishme që instalimi te mos behet ne një lokacion te përkohshëm për shume arsye: i. Instalimi i par dhe testimi duke përfshirë edhe trajnimin stafit është i përfshire në çmimin e furnizimit të pajisjes me garancionin e blerjes, dhe ky garancion ende është në fuqi. ii. Pajisja është e paketuar në vakum me mbështjellës speciale, dhe vetëm ekspertet e prodhueset mund ta hapin dhe të bëjnë instalimin e kësaj pajisje. iii. Instalimi i dytë i mikroskopit (SEM) ka kosto financiare të lartë dhe sipas rekomandimeve të prodhuesit kushton minimum 20.000 Euro, për shkak se pajisja duhet të ri-paketohet në pakot speciale dhe kalibrimi i pajisjes duhet të behet nga e para (kalibrimi i parë është i garantuar nga prodhuesi) dhe të gjitha pjesët duhet të ri-paketohen me kujdes dhe te futen në vakum me pajisje speciale. iv. Në rekomandimet e prodhuesit është tërhequr vërtetja se prodhuesi nuk garanton për pajisjen (fazën e garantimit) ne rast te dislokimit në vendin tjetër pas instalim të parë. Andaj, lidhur me sigurimin e hapësirës apo krijimin e kushteve të punë për laboratorin e SHGJK-së,	blerë dhe gjendet e paketuar. Andaj e gjetura dhe rekomandimi nuk ndryshojnë.

		Menaxhmenti i Ministrisë dhe SHGJK-së, ne vazhdimësi është përpjekur duke kërkuar nga MAP e cila është përgjegjëse për sigurimi e objekteve për Institucionet Qeveritare. Ka pas përpjekje qe dhe me Universitetin të arrihet marrëveshje për të vendos pajisjet ne hapësirat adekuate qe posedojnë ne Fakultete dhe të shfrytëzohen po ashtu nga studentet ne aftësimin e tyre gjatë studimeve por ka rezultuar pa sukses nga ana e përfaqësuesve Universitar. Ne këtë kuptim, MAP ka hartuar projektin për ndërtim të objektit për disa Agjencione dhe për SHGJK po ashtu dhe kjo tanimë varet nga MAP për ndërtimin e hapësirave të nevojshme.	